

VENDIM
Nr.88, datë 15.2.2006

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTURE DHE SHPËRBLIMIN E
KËSHILLIT KOMBËTAR TË SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përbërjes strukturore të Këshillit Kombëtar të Sportit, i cili të kryesohet nga zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në përbërje të ketë 14 anëtarë si më poshtë vijon:

- | | |
|---|------------------------|
| - Zëvendësministrin e Financave | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Shendetësisë | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Brendshëm | anëtar; |
| - Zëvendësministrin e Mbrojtjes | anëtar; |
| - Drejtorin e Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës,
Rinisë dhe Sporteve | anëtar; |
| - Presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit | anëtar; |
| - Presidentin e Federatës Shqiptare të Basketbollit | anëtar; |
| - Presidentin e Federatës Shqiptare të Volejbollit | anëtar; |
| - Presidentin e Federatës Shqiptare të Atletikës | anëtar; |
| - Presidentin e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes | anëtar; |
| - Presidentin e Federatës Shqiptare të Boksit | anëtar; |
| - Presidentin e Komitetit Olimpik Shqiptar | anëtar; |
| - Rektorin e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve
“Vojo Kushi” | anëtar; |
| - Një specialist nga Drejtoria e Sportit në Ministrinë
e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | koordinator/ sekretar. |

2. Këshilli Kombëtar i Sportit thirret si rregull nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, jo më shumë se 4 herë në vit.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha